



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____, 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës për informacion, regjistruar me numër rendor 32 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 6149 prot., datë 24.11.2023, në të cilën kërkonti informacion mbi pretendimin nëse gjyqtarja znj. {...} është shkarkuar në shkurt të vitit 1996 dhe nëse po, vënien në dispozicion të kopjes së këtij dokumenti, si dhe vënien në dispozicion të të gjitha masave disiplinore të ndërmarra ndaj gjyqtarës znj. {...} gjatë punës së saj në sistemin e drejtësisë, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Për periudhën për të cilën kërkonti informacion, organizimi dhe funksionimi i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe Ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001. Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse.

Ju informojmë se, për periudhën që ju kërkonti informacion, më konkretisht për vitin 1996, për znj. {...}, emëruar me Vendimin nr. 14, datë 21.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtare pranë Gjykatës Fier, bazuar në Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se,

1. Me Vendimin nr. 7, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është liruar nga detyra për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës.
2. Me Vendimin nr. 8, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës Mallakastër.

Në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të të gjitha masave disiplinore të ndërmarra ndaj gjyqtarës znj. {...}, ju informojmë se nga të dhënat që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk rezultojnë masa të tjera disiplinore ndaj gjyqtarës në fjalë gjatë punës së saj në sistemin e drejtësisë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!